

D E K R E T
Nr.7477, datë 12.3.1991

**PËR LEJIMIN E PUNËSIMIT JASHTË SHTETIT DHE KRIJIMIN E KOMITETIT TË
PUNËS DHE TË EMIGRIMIT EKONOMIK**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministrave;

PRESIDIUMI I KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS
POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Shtetasve shqiptarë me banim të përhershëm në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë u njohet e drejta për të punuar jashtë kufijve të shtetit.

Neni 2

Krijohet Komiteti i Punës dhe i Emigrimit Ekonomik si organ kolegjal e vendimor në varësi të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Përbërja, detyrat dhe të drejtat e Komitetit të Punës dhe të Emigrimit Ekonomik përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 4

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS
POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
SIHAT TOZAJ

KRYETARI
RAMIZ ALIA